



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.713/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada-Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur lidhur me apelin e Arben Dautaj, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara apelet Anr.713/2021, 714/2021, 715/2021, 716/2021, 717/2021, 718/2021, 719/2021, 720/2021, 721/2021, 722/2021, 723/2021, 724/2021, 725/2021, 726/2021, 727/2021, 728/2021, 729/2021, 730/2021, 731/2021, 732/2021 të datës 05.03.2021, të paraqitur nga Arben Dautaj, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet si: 0304E/02D, 0306E/03R, 0301X/01R, 0306E/02R, 0301E/02R, 0309/01R, 0306E/01R, 0301X/03R, 0316E/01R, 0316E/02D, 0304E/01R, 0309E/02D, 0310E/03D, 0325E/01R, 0306E/04D, 0301E/05D, 0305E/01D, 0312E/01D, 0312E/03D, 0313E/01R.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Arben Dautaj ka paraqitur në PZAP, apelet Anr.713/21, 714/2021, 715/2021, 716/2021, 717/2021, 718/2021, 719/2021, 720/2021, 721/2021, 722/2021, 723/2021, 724/2021, 725/2021, 726/2021, 727/2021, 728/2021, 729/2021, 730/2021, 731/2021, 732/2021, me të cilat pretendon se në vendvotimet si: 0304E/02D, 0306E/03R, 0301X/01R, 0306E/02R, 0301E/02R, 0309/01R, 0306E/01R, 0301X/03R, 0316E/01R, 0316E/02D, 0304E/01R, 0309E/02D, 0310E/03D, 0325E/01R, 0306E/04D, 031E/05D, 0305E/01D, 0312E/01D, 0312E/03D, 0313E/01R, në formularin e votimeve të kandidatëve nuk janë të përfshira të gjitha votat që parashtruesi i apelit pretendon se i ka marrë si kandidat, pasi që të njëjtat nuk janë përshkruar drejtë nga radhët e komisionerëve, duke konstatuar jo saktë gjendjen faktike, gjegjësisht numrin e votave. Parashtruesi i apelit këtë deklaratë e mbështet në familjarët dhe miqtë e tij, të cilët kanë votuar në këtë qendër votimi, dhe të njëjtit pretendojnë se nuk janë numëruar votat e tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.713/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Arben Dautaj i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.713/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.